

# BANKA E SHQIPËRISË

DEKLARATË PËR SHTYP

## ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2007

QERSHOR 2007



## ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2007

QERSHOR 2007

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e parë të vitit 2007, rezultoi me një tepricë prej 14.5 milionë eurosh. Flukset hyrëse të kapitalit kanë përballuar rreth 92 për qind të deficitit korent si dhe kanë çuar në rritjen e rezervës së autoritetit monetar.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente.
- Thellim i deficitit korent dhe i atij tregtar.
- Përmirësim i ecurisë së eksporteve.
- Rritje e detyrimeve financiare të vendit ndaj botës, e shprehur kryesisht në rritje të investimeve të huaja direkte dhe huamarrjes.
- Rritje e rezervave valutore të autoritetit monetar.

### I. LLOGARIA KORENTE

Tremujori i parë i vitit 2007 karakterizohet nga një aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të konsiderueshme të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente. Vëllimi i transaksioneve korente është rritur me rreth 12 për qind, krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar dhe shënoi një nivel prej 1.8 miliardë eurosh.

Mëse 94 për qind e shpenzimeve korente kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh. Rreth 35 për qind e të ardhurave korente ka hyrë në formën e transfertave, ndërkohë që shërbimet dhe eksportet e mallrave siguruan përkatësisht 34 për qind dhe 23 për qind të të ardhurave në valutë të vendit. Deficiti korent, për këtë tremujor, u vlerësua 183 milionë euro, me një rritje prej rreth 39 për qind kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2006.

Deficiti i lartë tregtar, që ka karakterizuar zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë gjatë këtij tremujori, ka neutralizuar efektin pozitiv të ngushtimit të deficitit të llogarisë së shërbimeve dhe të rritjes së flukseve pozitive të të ardhurave faktoriale neto, duke mbetur shkaktari kryesor në thellimin e deficitit korent për këtë periudhë.

#### I. 1. TREGTIA E JASHTME

Fluksi i lartë i shkëmbimeve tregtare vazhdon të karakterizojë edhe këtë tremujor të parë të vitit 2007. Vëllimi i përgjithshëm tregtar arriti afërsisht

vlerën e 811 milionë eurove, duke u vlerësuar 23 për qind më i lartë se niveli i të njëjtës periudhë të vitit paraardhës.

Në terma relativë, ritme të larta rritëse regjistrohen si për eksportet, ashtu edhe për importet, respektivisht 26 për qind dhe 22 për qind. Edhe pse eksportet janë rritur më shpejt se importet, baza e ulët e tyre nuk ka mundur të zbusë deficitin tregtar, që përbën një tipar të përhershëm të tregtisë së jashtme të vendit.

Deficiti tregtar për këtë periudhë vlerësohet në 448 milionë euro ose 21 për qind më i lartë se në tremujorin e parë të vitit 2006.

Raporti i mbulimit të importeve nga eksportet mbetet në nivele të ulta (rreth 29 për qind), duke dëshmuar për orientim të theksuar të tregtisë së jashtme drejt importeve.

Eksportet patën një sezon "lulëzimi", rezultat ky më tepër i përmirësimit të situatës së industrisë së tekstileve dhe këpucëve në vend, si dhe i eksporteve të mineraleve. Në fund të tremujorit të ardhurat nga eksporti arritën në 182 milionë euro, me një rritje në terma absolutë prej 38 milionë eurosh.

Struktura e eksportit vazhdon të mbetet në nivele të ulta diversifikimi, pa ndryshime të rëndësishme edhe gjatë këtij tremujori. Rreth 53 për qind të tij e zënë eksportet e tekstileve dhe këpucëve, që respektivisht patën një rritje prej 22 për qind dhe 8 për qind. Produktet minerale shfaqën një prirje rritëse të theksuar, duke dyfishuar vëllimet e tyre. Kontribut të ndjeshëm në këtë rritje dha eksporti i kromit, i cili përfaqësoi 40 për qind të mineraleve të eksportuara, i përqendruar drejt Kinës.

Në krahun e importeve, të dhënat tregojnë për zhvillime pozitive dhe zgjerim të mëtejshëm të prodhimeve kryesore të importuara. Vendi ynë shpenzoi afërsisht 630 milionë euro për blerje mallrash ose 114 milionë euro më tepër se viti paraardhës.

Kërkesa e lartë për energji elektrike, shoqëruar dhe me një situatë jo të favorshme energjitike në vend ka mbajtur të larta importet në këtë kategori, duke ndikuar ndjeshëm rritjen e shpenzimeve për importe të periudhës. Ndërkohë, ndryshe nga dinamika e këtyre viteve të fundit, karburatet dhe lubrifikantet kanë pësuar rënie (40 për qind) gjatë këtij tremujori krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2006, në njëfarë mënyre dhe si një kundërpërgjigje kundrejt çmimeve të larta të tyre.

Premtuese janë zhvillimet pozitive të importeve në makineri dhe pajisje (grupmall ky që përfaqëson 21 për qind të importit të përgjithshëm), tregues i rritjes së nivelit të investimeve në vend.

Gjatë këtij tremujori, eksportet tona duket se kanë shfaqur agresivitet më të madh drejt vendeve të rajonit. Ky grupim e rriti përfaqësimin në rreth 10 për qind të totalit të eksporteve. Ndikimin më të madh në këtë rritje e ka dhënë

4-fishimi i eksporteve drejt Kosovës. Pothuajse gjysma e eksporteve tona me rajonin kanë qenë të destinuara drejt Kosovës, ndërkohë që pjesa tjetër më së shumti, ka pasur si pikësynim tregjet e Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Përparësitë për tregtinë e lirë të mallrave, që erdhën nga hyrja në fuqi më 1 dhjetor 2006, e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me BE, duket se i kanë nxitur eksportuesit shqiptarë, pasi regjistrohen prirje rritëse të theksuara, me pothuajse të gjitha vendet pjesëmarrëse. Pavarësisht nga kjo, mbetet një shpërndarje jopërpjestimore e tyre, me përqendrim të lartë drejt fqinjëve Itali dhe Greqi (rreth 82 për qind e totalit të eksporteve).

Gjatë këtij tremujori, në kahun e importeve, struktura gjeografike shfaqet e njëjtë krahuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Mbizotërojnë partnerët tradicionalë (Italia, Greqia). Aplikimi i dispozitave të Marrëveshjes Interim<sup>1</sup>, në vend të MTL-ve me rajonin, duket se ka ndikuar negativisht në importet nga Bullgaria dhe Rumania. Ndërkohë, që me një pjesë të vendeve anëtare të BE-së importet kanë pësuar rënie. Nga ana tjetër, vlen për t'u theksuar kërkesa e lartë për mallra nga Serbia dhe Mali i Zi, importet e të cilave janë 5-fishuar, krahasuar me periudhën korresponduese të një viti më parë.

Flukset hyrëse nga Kina dhe Turqia, mbeten të një rëndësie të veçantë për vetë peshën që këto dy vende zënë në tregtinë botëtare. Gjatë këtyre viteve të fundit zgjerimi i importeve nga këto vende ka shfaqur ritme rritëse të qëndrueshme. Gjatë këtij tremujori ato kanë qenë respektivisht 64 për qind (Kina) dhe 36 për qind (Turqia), më të larta se tremujori i parë i vitit 2006.

## I. 2. ZHVILLIMET NË ZËRAT E TJERË TË LLOGARISË KORENTE

Transaksionet në shërbime regjistruan një vëllim prej rreth 579 milionë eurosh, me një rënie të lehtë (prej 2 për qind) kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë.

Tregtia në shërbime u mbyll me një bilanc negativ prej 30 milionë eurosh, i cili vlerësohet i përmirësuar me 14 për qind kundrejt tremujorit të parë të vitit 2006.

Përmirësimi i llogarisë neto të shërbimeve, i vërejtur edhe gjatë këtij fillim viti, i dedikohet rritjes së konsiderueshme të të ardhurave në kategorisë "shërbime të tjera". Kjo solli ndryshimin e kahut të pozicionit neto të kësaj kategorie si dhe kompensoi pjesërisht deficitin e krijuar në kategorinë "udhëtime".

Shërbimet e ofruara dhe të përfituara nga aktiviteti i turizmit, mbajnë peshën kryesore në tregtinë e shërbimeve. Eksporti dhe importi i shërbimeve të turizmit këtë tremujor, vlerësohen me rënie kundrejt tremujorit të parë të vitit 2006, duke mbyllur bilancin neto të tyre me një deficit prej 6 milionë eurosh.

Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, eksporti i turizmit ka sjellë 170 milionë euro të ardhura, një shifër 15 për qind më e ulët se ajo e një viti

më parë. Pavarësisht rritjes së lehtë të shpenzimeve ditore, rënia vjetore prej 14 për qind e numrit të jorezidentëve, e shoqëruar me rënien e koeficientit vlerësues të ditëqëndrimit, ka qenë faktori kryesor në ecurinë e të ardhurave të kësaj kategorie përgjatë këtij tremujori.

Rezidentët shqiptarë kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 177 milionë euro ose sa 62 për qind të totalit të dërgesave nga emigrantët. Vëllimi i shpenzimeve për udhëtime, për tremujorin e parë 2007, vlerësohet rreth 6 për qind më i vogël krahasuar me një vit më parë, si pasojë e rënies së koeficientëve vlerësues të ditëqëndrimit (27 për qind) pavarësisht rritjes së lehtë të shpenzimeve ditore dhe numrit të udhëtarëve (9 për qind).

Është tashmë e ditur se shërbimet e transportit dhe të sigurimeve ndjekin zhvillimet e aktivitetit tregtar të mallrave. Rritja e importit ka shkaktuar rritjen e importit të shërbimeve të këtyre kategorive. Kështu, në fund të kësaj periudhe importi i shërbimeve të transportit dhe ai i sigurimit të mallrave, vlerësohen respektivisht 17 dhe 37 për qind më të lartë se në periudhën korresponduese të një viti më parë.

Kategoria “shërbime të tjera” u mbyll me një suficit prej 1 milion eurosh, kundrejt deficitit prej 26 milionë eurosh, të tremujorit të parë të vitit të kaluar. Kjo kategori shërbimesh po zhvillohet me ritme të shpejta, veçanërisht përsa i përket krahut të eksporteve. Të ardhurat e përfutura nga eksporti i këtyre shërbimeve, kanë njohur rritje vjetore prej 40 për qind. Zhvillime pozitive të dukshme, brenda kësaj kategorie vihen re në shërbimet e konstruksionit, të komunikacionit dhe në shërbimet qeveritare.

Bilanci pozitiv i të ardhurave faktoriale në fund të periudhës (57.7 milionë euro) vlerësohet 18.7 për qind më i lartë se ai i tremujorit të parë të vitit 2006. Edhe këtë tremujor, ekonomia shqiptare ka përfutur burime valutore nëpërmjet të ardhurave nga puna e punëtorëve sezonalë, e atyre kufitarë, e interesave të akumuluar nga investimi i rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente dhe investimeve të mjeteve financiare në formën e investimeve të portofolit. Të ardhurat nga puna, përfaqësuan rreth 48 për qind të bilancit pozitiv të të ardhurave, ndërkohë, të ardhurat neto në formën e interesit nga investimet, kanë pësuar rritje prej 52 për qind. Shqipëria, gjatë tremujorit të parë të këtij viti, ka paguar 3.2 milionë euro për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm, të cilët vlerësohen lehtësisht në rënie (1.5 milionë euro) kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë.

Transfertat korente edhe këtë tremujor përfaqësohen kryesisht nga transfertat nga emigrantët. Këtë tremujor, këto të fundit regjistrojnë rreth 233 milionë euro dhe vlerësohen të kenë financuar deficitin tregtar në mallra, në masën 52 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë, këto transfertat vlerësohen 5 për qind më të larta. Transfertat nga emigrantët janë shoqëruar edhe nga transfertat të tjera private dhe shtetërore, respektivisht me 39 dhe 11 milionë euro.

## II. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Lëvizjet e kapitalit, gjatë këtij tremujori, rezultuan në një fluks neto prej rreth 169 milionë eurosh, duke mundësuar financimin e deficitit korent me rreth 92 për qind. Transfertat kapitale shënojnë rreth 27 milionë euro dhe karakterizohen kryesisht nga grante me karakter investimi si në sektorin shtetëror ashtu edhe në atë privat.

Llogaria financiare u mbyll me një bilanc pozitiv prej rreth 142 milionë eurosh. Pozicioni i kësaj llogarie këtë tremujor përkufizohet në rritje të detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën (me rreth 141 milionë euro). Krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar, fluksi neto i detyrimeve financiare vlerësohet të jetë 40 herë më i lartë. Ndërkohë, mjetet tona jashtë kanë pësuar një rënie prej 1 milion eurosh, kundrejt rritjes prej 34 milionë të periudhës korresponduese.

Rritja e detyrimeve financiare këtë tremujor, i dedikohet kryesisht flukseve hyrëse të kapitalit në formën e investimeve të huaja direkte si dhe të huamarrjes nga jashtë.

Fluksi i investimeve të huaja direkte regjistroi rreth 88 milionë euro. Duhet përmendur që këtë fillim viti, kanë qenë flukset hyrëse të kapitalit në fushën e industrisë përpunuese dhe të asaj prodhuese si dhe ato në fushën e komunikacionit, që kanë luajtur rolin kryesor në këto investime. Lëvrimet e kredive afatgjata dhe, të atyre të buta nga jashtë, të cilat mbeten një faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj botës, gjatë këtij viti vlerësohen 36 milionë euro, nga të cilat 88 për qind kanë shkuar për sektorin e qeverisë dhe atë publik. Kjo rritje, ka financuar kryesisht investimet dhe konsumin, e reflektuar kjo edhe në rritjen e importeve për konsum si dhe në nevojat për kapital dhe mallra kapitale të kompanive. Ndërkohë, huamarrja private duket të ketë ngadalësuar ritmet e rritjes së saj. Krahasuar me vitin 2006, rritja e detyrimeve të këtij sektori vlerësohet sa gjysma e fluksit hyrës të një viti më parë dhe zë vetëm 12 për qind të huamarrjes. Struktura e borxhit të jashtëm të krijuar nga huamarrja dominohet nga euro dhe sdr, respektivisht me 43 dhe 35 për qind.

Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit dhe të interesit vlerësohen në rreth 6.5 milionë euro, të barazvlefshme me 4 për qind të eksportit të mallrave, gjë që tregon për një aftësi paguese brenda niveleve të pranuar.

Ekonomia shqiptare këtë tremujor paraqitet me pothuaj të njëjtin pozicion ndërkombëtar të mjeteve financiare (me një rënie të vogël prej 1 milion eurosh), por me ndryshime strukturore. Këtë tremujor vihet re ndryshim i raportit të mjeteve të investimit. Mjetet në formën e investimeve të portofolit dhe të mjeteve valutore afatshkurtra janë zhvendosur në investime të rezervave të sistemit bankar në tregun ndërkombëtar në formën e depozitave. Kështu, rënia e investimeve të portofolit dhe e investimeve të mjeteve valutore afatshkurtra, respektivisht me 18.4 dhe 30 milionë euro është balancuar me rritjen prej rreth 46 milionë eurosh të depozitave.

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave valutore të Autoritetit Monetar, me rreth 14.5 milionë euro. Rezerva valutore në fund të tremujorit të parë 2007 shënoi nivelin 1.375 miliardë euro, e mjaftueshme për të mbuluar rreth 4.4 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Tabelë 1. Bilanci i Pagesave (në milionë euro).

	T-1 2006	T-2 2006	T-3 2006	T-4 2006	T-1 2007
Llogaria korente	-131.5	-153.2	-106.9	-143.1	-183.2
Eksporti i mallrave	144.4	165.7	153.2	167.3	181.9
Importi i mallrave	-515.2	-579.5	-568.5	-652.9	-629.5
Bilanci tregtar	-370.8	-413.8	-415.3	-485.6	-447.6
Shërbimet: kredi	277.4	282.0	337.2	298.1	274.2
Shërbimet: debi	-312.7	-291.5	-355.8	-301.6	-303.9
Të ardhurat: kredi	55.9	53.2	57.7	96.1	65.8
Të ardhurat: debi	-7.3	-12.2	-7.2	-27.6	-8.2
Transferta private pa shpërblim	209.7	216.3	271.1	269.2	225.3
Transferta shtetërore pa shpërblim	16.3	12.7	5.3	8.2	11.2
Llogaria kapitale	41.1	39.5	28.1	34.7	26.9
Llogaria financiare	64.3	98.9	10.1	229.8	142.2
Investime direkte	56.8	68.6	75.5	57.8	86.1
Investime portofoli	4.6	-3.1	21.7	3.9	18.5
Kapitale të tjera*	3.0	33.4	-87.0	168.1	34.8
Gabime dhe harresa neto	38.7	44.2	141.9	-36.0	28.6
Bilanci i përgjithshëm	15.6	29.5	76.1	85.4	14.5
Mjetet e rezervës	-15.6	-29.5	-76.1	-85.4	-14.5
Përdorim huash e kredish nga FMN	2.9	0.0	2.8	0.0	2.8
Ndryshimi total në rezerva	10.4	-6.5	-74.7	-67.9	13.3
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	-5.2	-23.0	-1.4	-17.5	-1.2

\* Nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.  
Burimi: Banka e Shqipërisë.

## SHËNIM

<sup>1</sup> Më 12 qershor 2006, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me BE- në në Luksemburg. Si rezultat, që prej dhjetorit 2006 është në fuqi një Marrëveshje e përkohshme ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë. Kjo marrëveshje zëvendësoi Marrëveshjen për Bashkëpunim Tregtar dhe Ekonomik ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shqipërisë, dhe do të jetë në fuqi deri sa të gjitha shtetet anëtare të BE-së, të ratifikojnë Marrëveshjen e Stabilizim – Asocimit me Shqipërinë.